

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sondazhi: 48 për qind e gjermanëve presin largimin e Merz deri në fund të vitit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/sondazhi-48-per-qind-e-gjermaneve-presin-largimin-e-merz-deri-ne-fund-te-vi-i587056
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 11:18:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 11:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9a82535ec4dc4562229e41f08e62639b4b369264338a97c3b2affe81f365c6a5
TEKSTI	688f39572dd345cbac9f3f0eff1863719763f762b7a82a0392b81a3306fb81dd
PAMJA	a85de1ae9ab8a1835255be681aefd92cb82881a6e79c99106529194a076555c2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	079df167ba3901bfb2185f4553d91baa37a6c2141b932139bb604f1d2be3714e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/079df167ba3901bfb2185f4553d91baa37a6c2141b932139bb604f1d2be3714e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)

English

1 e SHBA dhe Egjipti diskutojne krizat rajonale. Keshilltari i Trumpit telefonon Kajron: Po cenohet siguriaArtistet nga Prizreni vene ne skene dramen psikologjike "Pylli" ne fundit

Sondazhi: 48 për qind e gjermanëve presin largimin e Merz deri në fund të vitit



19 Shtator 2026, 13:45Bota TEMA



Gati gjysma e të anketuarve në Gjermani besojnë se kancelari Friedrich Merz nuk do të jetë më në detyrë deri në fund të këtij viti.

Kjo del nga një sondazh i publikuar nga YouGov, në një kohë kur CDU-ja përballet me presion të shtuar përpara zgjedhjeve rajonale të së dielës në Berlin dhe Mecklenburg-Vorpommern.

Sipas sondazhit, 48 për qind e 1,611 të anketuarve thanë se nuk presin që Merz të jetë ende kancelar në fund të vitit.

Në anën tjetër, 31 për qind besojnë se ai do të vazhdojë të mbajë postin, ndërsa 21 për qind nuk kanë dhënë një përgjigje të përcaktuar.

Sondazhi publikohet në prag të zgjedhjeve në Berlin dhe Mecklenburg-Vorpommern, ku CDU-ja po përballet me rezultate të dobëta në sondazhe.

Në Mecklenburg-Vorpommern, partia konservatore rrezikon të mbetet pranë ose nën pragun elektoral prej 5 për qind, ndërsa në Berlin gara për vendin e parë mbetet e ngushtë.

Presioni ndaj Merzit është shtuar pas rezultatit të CDU-së në Saksoni-Anhalt, ku AfD-ja doli forcë e parë me 43.8 për qind, ndërsa CDU-ja mori 17.2 për qind. Zhvillimet kanë nxitur diskutime brenda kampit konservator për të ardhmen politike të kancelarit.

Megjithatë, një ndryshim i mundshëm në drejtimin e CDU-së nuk do të sillte automatikisht zgjedhje të reja parlamentare.

Në rast të largimit të Merzit, Bundestagu mund të zgjedhë një kancelar të ri përmes procedurave kushtetuese, pa qenë e nevojshme një zgjedhje e përgjithshme.

Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe Mecklenburg-Vorpommern pritet të jenë një tjetër test i rëndësishëm për CDU-në dhe qeverinë e drejtuar nga Merz.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Përplasje në horizont? Izraeli kërkon “kompensim” nga SHBA-të](#)

12:55 Bota

Kanadaja dhe BE, modelet e bashkëpunimit dhe anëtarësimi i asociuar

11:35 Bota

[Vrasje brutale në Kolumbi! Autorja i zuri pritë para biznesit, biznesmeni 61-vjeçar vritet me 11 plumba](#)

10:05 Bota / 6 komente

JPMorgan: Nuk kemi më një skenar bazë për naftën, lufta me Iranin ka kaluar çdo parashikim

09:55 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.